



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KORPORATËS ENERGJETIKE TË KOSOVËS SH.A. PËR VITIN 2022

Raporti i nënshkruar nga  
Vlora Spanca,  
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2023

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit

Shtojca II: Pasqyrat financiare vjetore të audituara

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a. për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a. (KEK sh.a.), të cilat përmbajnë pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2022, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes/ve së përshkruar në paragrafin Baza për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare të bashkangjitura për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pozitës financiare të Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a. deri me 31 dhjetor 2022, performancës së saj, si dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2022, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

## Baza për Opinion të Kualifikuar

Çështjet që kanë ndikuar në opinionin e kualifikuar janë si në vijim:

- A1 Kompania nuk kishte kryer rivlerësimet periodike për pasuritë afatgjata për më shumë së 19 vjet. Vlera e pasurisë që mbahet në libra sipas modelit të rivlerësimit në fund të periudhës raportuese ishte 22 milion euro. Për më tepër, 75 % e gjithsej regjistrimit të pasurisë janë pasuri në përdorim por të zhvlerësuara tërësisht, pra më vlerë kontabël zero.
- A2 Kompania nuk kishte regjistruar pronat në emër të saj prej 1.17 hektar në Prishtinë dhe 116.88 hektar tokë rurale dhe pyjore në Drenas, ndërsa nuk kishte larguar nga regjistri pronat që më nuk i ka në pronësi, hekurudhat në vlerë neto prej 340 mijë euro dhe 1.12 hektar në Milloshevë. Poashtu, pronat e paluajtshme në regjistrin e kompanisë janë të regjistruara sipas totaleve të fletave poseduese, kjo pamundëson identifikimin e vlerës së drejtë të pronave individualisht.
- A3 Kompania, nuk kishte dhënë informacione shpjeguese të plota në pasqyra financiare në lidhje më detyrimet dhe pasuritë kontingjente.
- A4 Kompania kishte mbivlerësuar llogaritë e arkëtueshme për të hyrat nga interesi në shumën prej 454,608€.
- A5 Mos përputhje e gjendjes së llogarive të pagueshme në regjistrat kontabël të kompanisë me gjendjen tek furnitorët në vlerë prej 332,744€.

*Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike, Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion, transaksionet e kryera të Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a. kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

Çështjet që kanë ndikuar në konkluzionin e pajtueshmërisë janë si në vijim:

- A6 Kompania njih humbje prej 80% për të gjitha stoqet më të vjetra se 100 ditë, pa bërë grupime të artikujve të lidhur ose ngjashëm. Vlera e njohjes së provizionimit të stoqeve për vitin 2022 ishte 216 mijë euro.
- A7 Nënshkrimi i kontratave në vlerë 63,720€, përkatësisht 190,535€ gjashtë (6) muaj pas kryerjes së punëve përkatësisht 43 ditë pas marrjes së shërbimeve.
- A8 Kompania kishte ndërprerë kontrata kornizë me çmime të indeksuara në berzë dhe kishte nënshkruar kontrata të reja me negociim me çmime fikse të cilat kishin rezultuar më çmime më të pafavorshme për kompaninë.

*Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'.

Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike, Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

**Informacione të tjera të ndryshme nga pasqyrat financiare dhe raporti i auditorit mbi to**

Menaxhmenti është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet në raportin e menaxhmentit dhe deklaratën e qeverisjes korporative, por këto informacione nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditorit mbi këto pasqyra.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se janë me anomali materiale.

Ne kemi marrë parasysh nëse informacionet në raportin për menaxhmentin janë në përputhje me informacionet në pasqyrat financiare dhe deklarata e qeverisjes korporative përfshinë shpalosjet e kërkuara me nenet 7 dhe 10 të ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Nëse, bazuar në punën e kryer, arrijmë në përfundimin se në këto informacione ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Siç përshkruhet në seksionin e bazës për opinionin e kualifikuar:

- 1 Kompania nuk kishte kryer rivlerësimet periodike për pasuritë afatgjata për më shumë se 19 vjet. Vlera e pasurisë që mbahet në libra sipas modelit të rivlerësimit në fund të periudhës raportuese ishte 22 milion euro. Për më tepër, 75 % e gjithsej regjistrit të pasurisë janë pasuri në përdorim por të zhvlerësuara tërësisht, pra më vlerë kontabël zero.
- 2 Kompania nuk kishte regjistruar pronat në emër të saj prej 1.17 hektar në Prishtinë dhe 116.88 hektar tokë rurale dhe pyjore në Drenas, ndërsa nuk kishte larguar nga regjistri pronat që më nuk i ka në pronësi, hekurudhat në vlerë neto prej 340 mijë euro dhe 1.12 hektar në Milloshevë. Poashtu, pronat e paluajtshme në regjistrin e kompanisë janë të regjistruara sipas totaleve të fletave poseduese, kjo pamundëson identifikimin e vlerës së drejtë të pronave individualisht.
- 3 Kompania, nuk kishte dhënë informacione shpjeguese të plota në pasqyra financiare në lidhje me detyrimet dhe pasuritë kontingjente.
- 4 Kompania kishte mbivlerësuar llogaritë e arkëtueshme për të hyrat nga interesi në shumën prej 454,608€.
- 5 Mos përputhje e gjendjes së llogarive të pagueshme në regjistrat kontabël të kompanisë me gjendjen tek furnitorët në vlerë prej 332,744€.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim

Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a..

### **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a. është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a. në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, si dhe të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>2</sup>

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrim një raport të auditimit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është niveli i lartë sigurie, por nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keqdeklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsye pritet që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre Pasqyrave Financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të KEK sh.a. me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Si pjesë e auditimit, në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-t, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimit material të Pasqyrave Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit konform atyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për keqdeklarimin që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulimin, falsifikimin, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitet të kontrollit të brendshëm të Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a..
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.

- Nxjerrim një përfundim nëse baza e vijimësisë së kontabilitetit është e përshtatshme për përdorim nga menaxhmenti, bazuar në provat e siguruar të auditimit, nëse ekziston pasiguria materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a., për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet përkatëse në Pasqyrat Financiare ose, nëse zbulimet e tilla janë të papërshtatshme ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të bëjnë që NP-ja të pushojë së vazhduari sipas parimit të vijimësisë.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare, përfshirë edhe shpalosjet, për t'u siguruar se Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjisllacionin në fuqi.



## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Gjetjet që kanë ndikuar opinionin e pasqyrave financiare janë: mos rivlerësimi periodik i pasurive afatgjata që mbahen në libra më vlerë të drejtë, mos përditësimi i pronave të paluajtshme më ndryshimet e ndodhura ndër vite, mos shpalosje e kontingjencave, mbivlerësim i llogarive të arkëtueshme dhe nënvlerësimi i llogarive të pagueshme.

Të konkluzioni i pajtueshmërisë kanë ndikuar gjetjet si politika e papërshtatshme për provizionimin e stoqeve, nënshkrimi i kontratave pas kryerjes së punëve/shërbimeve dhe ndërprerja e kontratave sipas çmimeve në berzë dhe nënshkrimi i kontratave të reja më çmime fikse. Ndërsa gjetjet tjera të cilat nuk kanë ndikuar në opinion por vetëm të menaxhimi financiar dhe i pajtueshmërisë janë në brendi të raportit.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e burimeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 15 rekomandime të reja.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 3.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja A1 - Mos rivlerësimi periodik i pasurive afatgjata

##### Gjetja

Sipas SNK 16, nëse njësia ekonomike zgjedh modelin e rivlerësimit atëherë, rivlerësimet do të bëhen në mënyrë të rregullt të mjaftueshme që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e pasurive afatgjata (prona, impiantet dhe pajisjet) nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej nëse do të përdorej vlera e drejtë në fund të periudhës raportuese. Frekuenca e rivlerësimit varet nga ndryshimet në vlerën e drejtë të zërave të pasurive afatgjata (prona, impiantet dhe pajisjet) që rivlerësohen, nëse pasuritë nuk pësojnë ndryshime të rëndësishme dhe të shpeshta në vlerën e drejtë, rivlerësohet zëri vetëm çdo tre ose pesë vjet.

Kompania, kishte në regjistër pasuri që mbahen sipas modelit të rivlerësimit në vlerë prej 22 milion euro, për të cilat nuk ishin kryer rivlerësimet periodike për më shumë se 19 vjet. Kjo vlerë mund të ndryshoj materialisht nëse do të përdorej vlera e drejtë në fund të periudhës raportuese. Për më tepër, 75% e gjithsej regjistrit të pasurisë (14,984 prej 19,887 artikujve) janë pasuri në përdorim por të zhvlerësuara tërësisht, pra më vlerë kontabël zero.

Kjo kishte ndodhur për shkak se Menaxhmenti e kishte konsideruar industri specifike dhe vështirë të zbatueshme rivlerësimet në praktikë.

**Ndikimi**

Mos kryerja e rivlerësimit të pasurive afatgjata në frekuenca të rregullta mund të këtë ndikim material në vlerën e prezantuar të pasurive afatgjata dhe rrjedhimisht edhe në njohjen e shpenzimeve të zhvlerësimit për vitin dhe fitimin/humbjen e vitit.

**Rekomandimi A1**

Bordi i Drejtorëve të sigurojë se do të kryhen rivlerësimet e pasurive në frekuenca të rregullta të mjaftueshme që të sigurohet se vlera e prezantuar e pasurive në pasqyra financiare nuk ndryshon materialisht nga vlera e tyre e drejtë në fund të periudhës raportuese.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)**

Me gjerësisht shih Shtojcën I

**Çështja A2 - Mos përditësimi i regjistrit të pasurisë me ndryshimet e ndodhura ndër vite për pronat e paluajtshme**

**Gjetja**

Sipas SNK 16, Toka, ndërtesa, makineria dhe pajisjet janë zëra materialë që mbahen për përdorim në prodhimin ose furnizimin e të mirave ose shërbimeve, për dhënie me qira palëve të treta ose për qëllime administrative dhe pritet të përdoren gjatë më shumë se një periudhë.

Kompania nuk kishte përditësuar regjistrin e pasurisë më ndryshimet e ndodhura ndër vite për pronat e paluajtshme, si në vijim:

- Sipas çertifikatës së pronësisë, kompania ka në pronësi 1.7 hektar tokë ndërtimore në qendër të Prishtinës. Prej tyre, vetëm 5.33 ari tokë janë të regjistruar në regjistrin e pasurisë ndërsa pjesa tjetër nuk është e regjistruar për shkak se sipas zyrtarëve, kompania nuk ka kontroll mbi këtë pjesë të pasurisë. Tutje ne kemi identifikuar se kompania ndër vite ishte në procese gjyqësore për një lokal me sipërfaqe 140m<sup>2</sup> brenda kësaj parcele ku në mars të vitit 2023 kishte fituar rastin ndërsa për pjesën tjetër të pronës kompania nuk kishte ndërmarr veprime ligjore për kthimin e kontrollit mbi pronën.
- Kompania nuk kishte regjistruar në regjistrin e pasurisë 116.88 hektar tokë rurale dhe pyjore në Vasilevë, Komuna e Drenasit edhe pse sipas ekstraktit fletës poseduese janë në emër të kompanisë.
- Kompania, ende nuk kishte larguar nga regjistri i pasurisë, 1.12 hektar në Milloshevë të cilat më vendim të Qeverisë, në vitin 2014, janë bartur tek Kompania Rajonale e Ujësllësit Prishtina sh.a.
- Kompania ka në regjistër pesë pasuri, infrastrukturë hekurudhore, me vlerë neto në libra prej 341 mijë euro për të cilat nuk ka ofruar dëshmi mbi pronësinë/kontrollin mbi to. Sipas çertifikatës së pronësisë kjo infrastrukturë hekurudhore është në emër të NPSH Hekurudhat e UNMIK-ut, zona kadastrale në Podujevë.
- Kompania ka regjistruar pronat e paluajtshme në regjistrin e pasurisë të përmbledhura nga fletat poseduese, të kohës së UNMIK-ut dhe jo veç e veç sipas numrit të parcelave. Fakti që fletat poseduese përmbajnë numër të madh të parcelave dhe në disa raste edhe lloje të ndryshme të pronës brenda të njëjtës fletë poseduese si tokë ndërtimi, rurale, pyjore, ndërtesë, rrugë, kanë pamundësuar në identifikimin e vlerës së drejtë të pronave individualisht.

Mos prezantimi i plotë dhe i saktë i pronave të paluajtshme ka ndodhur për shkak të mungesës së veprimeve të mjaftueshme ndër vite për trajtimin e çështjeve pronësore të kompanisë.

#### **Ndikimi**

Mos përditësimi i regjistrin të pasurisë me gjendjen aktuale të pronave të paluajtshme ndikon në nënvlerësimin përkatësisht mbivlerësimin e vlerës së pasurisë afatgjatë në pasqyrat financiare.

#### **Rekomandimi A2**

Bordi i Drejtorëve të sigurojë së janë marr veprimet e nevojshme për trajtimin e çështjeve pronësore të kompanisë dhe të përditësoj regjistrin e pasurisë me gjendjen aktuale duke prezantuar saktë dhe të drejtë pasurinë afatgjatë të kompanisë.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A3 - Mos prezantimi i plotë i informacioneve shpjeguese për kontingjencat**

##### **Gjetja**

Sipas SNK 37, Provizionet, detyrimet dhe pasuritë kontingjente, njësia ekonomike duhet të jap informacion shpjegues për detyrimet dhe pasuritë kontingjente, përveç kur mundësia e një hyrje/daljeje burimesh që përfshin përfitime/humbje ekonomike nuk ekziston më.

Menaxhmenti nuk kishte kryer vlerësimet e duhura lidhur me detyrimet dhe pasuritë kontingjente para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore.

Më 24 shkurt 2023, kompania kishte pranuar njoftimin për shkeljet e konstatuara në lidhje me blerjen e energjisë, pagesat dhe nominimet ku edhe ishte njoftuar se do të aplikohen dispozitat e masave ndëshkimore ashtu siç parashihet me legjislacionin në fuqi. Për këto shkelje, Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), më 05 maj 2023, kishte vendosur gjobën prej 3.2 milion euro.

Po ashtu kompania nuk kishte shpalosur si pasuri kontingjente, tre konteste pronësore (një lokal në Prishtinë dhe dy banesa në Drenas) të fituara në gjykata në mars 2023.

Kjo kishte ndodhur për shkak se Menaxhmenti nuk kishte kryer vlerësimet e nevojshme për kontingjencat para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore.

**Ndikimi** Mos prezantimi i informacioneve shpjeguese për ngjarjet që i plotësojnë kriteret të trajtohen si detyrime dhe pasuri kontingjente ka ndikim në plotësinë dhe kuptueshmërinë e pasqyrave financiare nga përdoruesit.

**Rekomandimi A3** Bordi i Drejtorëve të sigurojë, së bëhen vlerësimet e nevojshme për kontingjencat dhe të jepen informacionet shpjeguese të plota në pasqyra financiare.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)**

Me gjerësisht shih Shtojcën I

#### **Çështja A4 - Njohje në periudhë të gabuar e llogarive të arkëtueshme për të hyrat nga interes**

**Gjetja** Korniza konceptuale specifikon se në mënyrë që të plotësojnë objektivat e tyre, pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj baze, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen kur ato ndodhin (dhe jo kur mjetet monetare ose ekuivalentët e tyre janë arkëtuar ose paguar) dhe ato regjistrohen në regjistrat kontabël dhe raportohen në pasqyrat financiare të periudhave me të cilat ato lidhen.

Marrëveshja bazë në mes Kompanisë me KEDS dhe KESCO për furnizim me shumicë të energjisë parasheh që të paguhet kamatë prej tetë përqind (8 %) mbi normën e LIBOR-it për faturat e papaguara brenda afatit.

Ne kemi identifikuar se kompania kishte faturuar interes për arkëtimet në vonesë ndaj KESCO dhe KEDS në vlerë 454,608€ të cilat ishin njohur në vitin 2022, në periudhën e gabuar kontabël. Prej tyre 178,101€ i përkasin vitit 2021 dhe 276,507€ i përkasin vitit 2023.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos vëmendjes së mjaftueshme me rastin e regjistrimit të faturave të shitjes në periudhat e duhura kontabël.

**Ndikimi** Njohja e të arkëtueshmeve në periudhën e gabuar ka ndikuar në mbivlerësimin e llogarive të arkëtueshme përkatësisht të hyrave nga interesi për vitin 2022.

**Rekomandimi A4** Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë njohjen e llogarive të arkëtueshme përkatësisht të hyrave nga interesi në periudhën e duhur kontabël në mënyrë që pasqyrat financiare të përmbajnë vetëm transaksionet dhe ngjarjet që i përkasin vitit.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A5 - Mos përputhje e detyrimeve në regjistrat kontabël të kompanisë më gjendjen tek furnitorët**

**Gjetja** Sipas nenit 12 të Ligjit nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, kërkohet që Shoqëritë tregtare, verifikojnë të paktën një (1) herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmime të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. Po ashtu ndër tjera, neni 2, përcakton se inventarizimi duhet të barazohet me librat kontabël.

Për të testuar saktësinë e llogarive të pagueshme tregtare, përveç procedurave tjera, ne kemi dërguar 11 letër konfirmime tek furnitorët me vlerë të përbashkët prej 13,036,777€. Deri në përfundim të auditimit kemi pranuar nëntë (9) letër konfirmime me vlerë të përbashkët prej 13,408,258€, prej të cilave më anë të procedurave shtesë të auditimit kemi vërejtur se në tre raste, kompania kishte nënvlerësuar obligimet e papaguara në shumë prej 332,744€. Këto mos barazime kishin të bëjnë:

- në një rast me faturën për jobalancat në sistem prej KOSTT-it në vlerë prej 296,195€. Sipas Menaxhmentit ky mos barazim kishte të bënte me një faturë të KOSTT-it për jobalancat e cila kontestohet nga kompania me pretendimin se KOSTT është shkaktar i kësaj jobalance dhe e vlerësojnë si rast specifik që nuk duhet të trajtohet me Rregullat e Tregut në fuqi. Sipas Ligjit për Energjinë Elektrike, neni 22 ndër tjera përcakton se Operatori i Sistemit të Tregut (KOSTT) është përgjegjës për llogaritjen e jobalancit të energjisë elektrike dhe çmimit të jobalancit për çdo pjesëmarrës si dhe faturimin në përputhje me Rregullat e Tregut. Tutje, neni 23 përcakton se Rregullat e Tregut janë të detyrueshme për të gjithë pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike në Kosovë.
- në rastin tjetër mos barazimi ishte ndaj Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit Prishtina sh.a., në vlerë prej 31,857€. Sipas Menaxhmentit mos barazimi me KRU Prishtinën është për shkak se një pjesë e borxhit kontestohet nga kompania e cila ndërlidhet me ish njësitë e biznesit të kompanisë. Në qershor 2023 kompania ka filluar procesin e barazimit me KRU Prishtinën mirëpo në pasqyra financiare vjetore nuk kishte prezantuar gjendjen e obligimeve ndaj KRU Prishtina ashtu siç ishte me 31 dhjetor 2022.
- ndërsa për mos barazimin ndaj Kompanisë Rajonale të Mbeturinave Pastrimi sh. a. në vlerë prej 4,692€, kompania në qershor të vitit 2023 kishte kërkuar nga KRM Pastrimi sh. a., detaje të faturave të papaguara, edhe pse për këto detaje kompania ishte e njoftuar më datën 25.04.2023 me rastin e letër konfirmimit.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos harmonizimit periodik të gjendjes së llogarive të pagueshme më furnitorët.

#### **Ndikimi**

Mos barazimet periodike më furnitorët kanë ndikuar në prezantim të pasaktë të llogarive të pagueshme në pasqyra financiare.

#### **Rekomandimi A5**

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për harmonizimin periodik të gjendjes mes kompanisë dhe furnitorëve në mënyrë që të këtë pasqyrë sa më të qartë për detyrimet e saj ndaj furnitorëve.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)**

Me gjerësisht shih Shtojcën I

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A6 - Politikë e papërshtatshme për provizionimin e stoqeve

**Gjetja** Sipas SNK 2, stoqet zakonisht zhvlerësohen deri në vlerën neto të realizueshme, artikull për artikull. Megjithatë, në disa raste mund të jetë më e përshtatshme që artikujt e lidhur ose të ngjashëm të grupohen.

Kompania për të gjitha stoqet me të vjetra se 100 ditë njihet provizion 80% të koston së blerjes. Pra provizionimi kalkulohet vetëm në bazë të vjetërsisë dhe nuk merr për bazë edhe faktor tjerë specifik të stoqeve. Kompania nuk kishte bërë grupime të artikujve të lidhur ose me karakteristika të ngjashme ashtu siç kërkohet me SNK 2, për të aplikuar provizione me të përshtatshme sipas llojeve të grupimeve. Vlera e provizionimit për vitin 2022 ishte 216 mijë euro.

Kjo kishte ndodhur për shkak se kompania e kishte konsideruar si më të përshtatshme për rrethanat provizionimin e të gjithë artikujve bazuar vetëm në kriterin e vjetërsisë.

**Ndikimi** Provizionimi i papërshtatshëm mund të këtë ndikim në njohjen e pasaktë të shpenzimeve të provizionimit dhe vlerën neto të stoqeve.

**Rekomandimi A6** Bordi i Drejtorëve të siguroj që të bëhet rishikimi i politikës së provizionimit të stoqeve në mënyrë që provizionimi të bëhet sipas grupeve të artikujve të lidhur ose me karakteristika të ngjashme ashtu siç kërkohet me SNK 2.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

### Çështja A7 - Nënshkrimi i kontratave pas kryerjes së punëve dhe shërbimeve

**Gjetja** Sipas Ligjit të Prokurimit, neni 9, ndër të tjera përcakton se para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit, Zyrtari Kryesor Administrativ i autoritetit kontraktues duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim formal i nevojave dhe që rezultatet e këtij vlerësimi të regjistrohen formalisht me shkrim dhe të ruhen në dokumentacionin e autoritetit kontraktues. Me këtë vlerësim përcaktohen, lloji dhe përmasat e sakta të nevojave të veçanta të autoritetit kontraktues që prokurimi i propozuar parasheh t'i plotësojë, vlera e parashikuar, lloji i propozuar dhe kushtet përmbajtësore të kontratës publike që do të jenë lëndë e prokurimit të planifikuar.

Kompania, më 23 dhjetor 2021 kishte lidhur kontratë në vlerë prej 248,650€ me titull “Angazhimi i ekspertëve për inspektimin dhe riparimin e dëmeve të krijuara nga avaria në turbinën e shtypjes së ulët në njësinë B2-TCB”. Gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate, ekspertët e angazhuar kishin vlerësuar se duhet të kryhen punë shtesë dhe në dakordim me kompaninë këto punë ishin kryer gjatë muajit janar 2022. Për këto punë shtesë kompania me 02 maj 2022 kishte pranuar faturën në vlerë 63,720€ ndërsa kontrata ishte nënshkruar me 30 qershor 2022, rreth 6 muaj pas përfundimit të punëve. Kjo kontratë ishte emërtuar si “Riparimi i lopatave të dëmtuara dhe matjet e vibrimeve dhe balancim në turbinën e shtypjes së ultë në njësinë B2”.

Në një rast tjetër kompania kishte nënshkruar marrëveshje për marrjen e shërbimit të sigurimit fizik të objekteve 43 ditë pas marrjes së shërbimeve. Marrëveshja ishte nënshkruar me 15 shtator 2022 për marrjen e shërbimeve për periudhën prej 03 gusht deri më 02 shtator 2022. Vlen të theksohet se kompania për këtë shërbim kishte zhvilluar paraprakisht procedura të prokurimit të cilat kishin përfunduar më procese ankimore në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).

Kjo kishte ndodhur për shkak se punët/pozicionet e pa parashikuara gjatë ekzekutimit të kontratës, që janë vlerësuar të domosdoshme, e tejkalonin 10% të kontratës bazë si dhe për shkak të vonesave në zgjidhjen e proceseve ankimore në OSHP.

#### **Ndikimi**

Kryerja e punëve dhe shërbimeve pa kontratë dhe pastaj kontraktimi përveç se është në kundërshtim me ligjin e prokurimit mund të ndikoj në çmime më të pa favorshme nëse do të përdorej procedura e hapur konkurruese.

#### **Rekomandimi A7**

Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj së vlera e parashikuara, lloji i propozuar dhe kushtet përmbajtjesore të kontratës publike të bëhen me kohë si dhe nënshkrimi i kontratave të bëhet para fillimit të ekzekutimit të punëve përkatësisht marrjes së shërbimeve.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A8 - Ndërprerje e pa arsyeshme e kontratave kornizë me çmime të bursës dhe nënshkrim i kontratave të reja me çmime fikse**

##### **Gjetja**

Sipas nenit 4.3 të kontratave kornizë për furnizim me acid klorhidrik për Termocentralin Kosova A (TCA) dhe Termocentralin Kosova B (TCB), çmimi i vendosur në kontratë do t'i nënshtrohet ndryshimeve nëse çmimet e Acidit Klorhidrik sipas berzës ICIS - LOR London ndryshojnë rriten apo zvogëlohen dhe paritetit Euro/USD (€/€), atëherë palët kontraktuese do t'i korrigjojnë çmimet e kontratës dhe do t'i ndryshojnë ato çmime për atë ndryshim (+/-). Për shkak të ndryshimeve të çmimeve të acidit klorhidrik në tregun botëror, ku acidi klorhidrik e ka çmimin e berzës (ICIS LOR - Londër), çmimet e acidit klorhidrik do të korrigjohen çdo fillim muaji rriten-zvogëlohen sipas formulës së përcaktuar.



Kompania, më 14 mars 2022, kishte ndërprerë më marrëveshje miqësore dy kontratat aktive për "Furnizimin me acid klorhidrik", për nevojat e TCA-së dhe TCB-së, më arsyetimin që sipas furnizuesit ishin rritur çmimet e produktit dhe kostot e transportit dhe e kishte të pamundur realizimin e këtyre kontratave në vazhdim. Duke pasur parasysh se lëvizja e çmimeve ishte e paraparë në kontratat kornizë ne kemi kërkuar sqarime shtesë mirëpo nuk kemi marrë arsye bindëse për ndërprerje.

Procesi i ndërprerjes dhe lidhjes së kontratave të reja është sqaruar në vijim:

Kontrata e ndërprerë për TCA-në, në vlerë 179,025€ për sasinë prej 1,200 ton (149€/ton) ishte lidhur me 13 nëntor 2020 dhe kishte afat deri me 12 nëntor 2022. Në datën e ndërprerjes vlera financiare e realizuar e kontratës ishte 102,000€ apo 57% e vlerës së kontraktuar ose 790 ton apo 66% e sasisë së kontraktuar.

Ndërsa kontrata e ndërprerë për TCB-në, në vlerë prej 181,104€ për sasinë 1,050 ton (172€/ton) ishte lidhur më 02 qershor 2020 dhe kishte afat deri më 02 qershor 2023. Në datën e ndërprerjes vlera financiare e realizuar e kontratës ishte 98,772€ ose 55% e vlerës së kontraktuar ose 764 ton apo 73% e sasisë së kontraktuar.

Pas ndërprerjes së kontratave, kompania kishte zhvilluar dy herë aktivitetin e hapur të prokurimit (prill dhe maj 2022) por procedurat kishin dështuar për shkak të mos pranimit të ofertave të përgjegjshme. Me tutje, kompania kishte zhvilluar dy herë aktivitetin e prokurimit duke e përdorur procedurën e negociuar (maj, dhe qershor 2022) por nuk kishte lidhur kontratë për shkak se çmimet ishin më të larta se sa vlera e parashikuar.

Megjithatë, kompania përmes procedurave të negociuara të prokurimit, në vazhdim kishte lidhur katër kontrata për furnizim me acid klorhidrik më çmime fikse (të pa indeksuara në berzë) si në vijim, kontrata e muajit qershor më 295€/ton (29,500€ për sasinë për 100 ton), kontrata e muajit korrik më 326€/ton (32,686€ për sasinë për 100 ton), kontrata e muajit shtator më 720€/ton (71,980€ për sasinë për 100 ton) dhe kontrata e muajit dhjetor më 566€/ton (14,160€ për 25 ton).

Kjo kishte ndodhur për shkak se Menaxhmenti ishte pajtuar më kërkesën e OE për ndërprerje të kontratave për shkak të rritjes së çmimeve edhe pse rritja/zvogëlimi i çmimeve ishin të parapara në kontratat kornizë.

#### **Ndikimi**

Ndërprerja e kontratave kornizë për furnizim më acid klorhidrik kishte shkaktuar çrregullim në furnizim, emergjencë dhe ka çuar në kontrata të negociuara, të cilat kanë siguruar më pak konkurrencë.

#### **Rekomandimi A8**

Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj që kompania me rastin e furnizimeve të përdor procedura të hapura të prokurimit si dhe indeksimin e çmimeve sipas berzës kur kjo është e mundur.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Kontrollat e brendshme në raportimin financiar

Në vijim janë çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e të dhënave dhe përgatitjen në Pasqyra Financiare.

#### Çështja A9 - Vonesat në aprovimin e pasqyrave financiare

##### Gjetja

Sipas Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 31.3, përcakton se brenda 45 ditëve pas përfundimit të çdo viti kalendarik, Zyrtarët e NP-së, në përputhje me Nenin 14.1, do të përgatisin dhe dorëzojnë Bordit të Drejtorëve të NP-së, një raport vjetor për vitin kalendarik të sapo përfunduar, në të cilin përshkruhen veprimet e marra, rezultatet financiare të arritura si dhe efektshmëria e përgjithshme në realizimin e caqeve të vendosura në Planin e Biznesit. Brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit vjetor, Bordi i Drejtorëve të NP do ta shqyrtojë, ndryshojë dhe siç e sheh të arsyeshme ta miratojë dhe dorëzojë, secilin raport të këtillë vjetor tek Njësia për Politikën dhe Monitorimin e NP-ve, e cila e publikon atë në faqen e saj zyrtare në internet dhe sipas rastit, Qeverisë ose Komisionit (eve) Komunal të Aksionarëve.

Kompania, kishte finalizuar me 42 ditë vonesë pasqyrat financiare vjetore. Pasqyrat financiare ishin finalizuar me 27 prill 2023 dhe jo siç kërkohet me ligjin për NP-të që të finalizohen deri me 15 mars të vitit vijues. Kompania kishte dorëzuar dy drafte (versione të pa nënshkruara) me 16 shkurt përkatësisht 15 mars 2023.

Kjo kishte ndodhur për shkak se kompania nuk kishte arritur të finalizonte me kohë raportet e inventarizimit të pasurive dhe detyrimeve si dhe kryente korrigjimet e nevojshme në pasqyrat financiare vjetore.

##### Ndikimi

Mos hartimi, aprovimi si dhe publikimi me kohë i pasqyrave financiare finale, ndikon në mos përmbushjen e kërkesave ligjore, si dhe mos informimin e shfrytëzuesve të pasqyrave financiare në afatin e paraparë kohor.

##### Rekomandimi A9

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se pasqyrat financiare janë përgatitur, aprovuar dhe publikuar në afatet e përcaktuara ligjore.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

### 2.3.2 Llogaritë e arkëtueshme

Vlera bruto e zërit financiar të llogarive të arkëtueshme e prezantuar në pasqyrën e pozitës financiare ishte 93,658,000€ Brenda këtij zëri janë prezantuar llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera. Ne kemi testuar 15 mostra për testim substancial në vlerë të përbashkët 87,365,479€.

#### Çështja A10 - Mos harmonizimi periodik me klientët dhe mungesa e dokumenteve burimore

##### Gjetja

Sipas, Ligjit nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 12, kërkohet që Shoqëritë tregtare, verifikojnë të paktën një (1) herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmime të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. Po ashtu ndër tjera, neni 2, përcakton se inventarizimi duhet të barazohet me librat kontabël.

Kompania nuk kishte bërë harmonizimin e llogarive të arkëtueshme me klientët. Ne përmes kompanisë kemi dërguar 15 letër konfirmime për të arkëtueshmet bruto në vlerë 87,365,479€, dhe në 10 raste në vlerë prej 9,974,123 nuk kemi pranuar ato.

Ne kemi zhvilluar procedurat alternative të auditimit dhe kemi vërejtur se:

- në tre raste përkundër se ishin të arkëtueshme shumë të vjetra kompania nuk kishte ndërmarrë ndonjë procedurë ligjore për arkëtimin e tyre,
- në një rast kompania mbante si të arkëtueshme vlerën prej 101,580€ edhe pse sipas dëshmime të siguruara kjo e arkëtueshme ishte e paguar në tërësi,
- Për më tepër, kompania mban një kërkesë prej 45,088€ ndaj Bankës Kreditore të Prishtinës (BKP), për të cilën përveç kartelës analitike nuk na ka ofruar dëshmi burimore për këtë shumë.

Të gjitha rastet e lartcekura kompania kishte provizionuar me 100% të vlerës se tyre.

Kjo kishte ndodhur për shkak se kompania nuk kishte kryer procesin e harmonizimit të gjendjeve me klientë në baza periodike.

##### Ndikimi

Mos harmonizimi periodik me klientët mund të ndikoj në prezantimin e pasaktë të gjendjes se llogarive të arkëtueshme.

##### Rekomandimi A10

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë procedura të harmonizimit periodik të llogarive me debitorët dhe gjithashtu të rishqyrtoj regjistrin llogarive të arkëtueshme në mënyrë që pasqyrat financiare të prezantojnë sa më saktë dhe drejt gjendjen e kompanisë.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.3 Të hyrat

Të hyrat e realizuara ishin në vlerë 307,961,000€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga shitja e rrymës 283,517,000€, të hyrat nga grantet 22,245,000€, të hyrat tjera 2,199,000€. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale të detajeve në vlerë 76,558,979€.

#### Çështja A11 - Mungesa e rregullores së brendshme për tregtimin e energjisë elektrike

**Gjetja** Procedura për tregtimin e energjisë elektrike PR-MO-11 përcakton parimet e përgjithshme të blerjes dhe shitjes së energjisë elektrike. Neni 2 pika 2 Për detaje më specifike, kompanitë duhet të zhvillojnë procedurën e brendshme të bazuar në funksionin e tyre në treg, e cila duhet të jetë në përputhje me këtë procedurë.

Ne kemi identifikuar që kompania ende nuk ka arritur të përgatisë dhe aprovojë procedurën për tregtimin e energjisë elektrike, edhe pse kjo është kërkesë ligjore që kompanitë të zhvillojnë procedurën e brendshme të bazuar në funksionin e tyre në treg.

Sipas zyrtarëve të kompanisë shkaqet e mos hartimit të procedurës së tillë ishin ndërrimet e shpeshta në bordin e drejtorëve të kompanisë.

**Ndikimi** Përderisa kompania operon në tregtim të energjisë pa procedurë të shkruar mund të ndikoj në ndëshkime nga rregullatori dhe vështirësi gjatë zhvillimit të aktiviteteve të tregtimit.

**Rekomandimi A11** Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se janë hartuar dhe aprovuar të gjitha rregulloret dhe procedurat e nevojshme për funksionimin e kompanisë, si dhe të bëhet azhurnimi i tyre bazuar në nevojat e kompanisë.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.4 Shpenzimet operative

Shpenzimet operative janë realizuar në shumën 190,913,000€. Ato kanë të bëjnë me shpenzime të zhvlerësimit dhe amortizimit, personelit, energjia elektrike dhe komunalitë, mirëmbajtjes, shpenzimet e linjtit, materialet dhe furnizimet dhe të tjera. Kemi testuar 48 mostra për teste substanciale në shumën 73,014,528€.

#### Çështja A12 - Përsëritja e ankandeve jo në pajtim më procedurën e ZRrE-së për tregtim të energjisë

##### Gjetja

Sipas Procedurës për tregtimin e energjisë elektrike të ZRrE-së, neni 12, pika 1, ndër të tjera përcakton se kriteri përzgjedhës për blerje afatshkurtër të energjisë elektrike është kostoja ekonomike më e favorshme e Ofertës, përderisa sipas pikës 3 kriteri përzgjedhës për shitje afatshkurtër të energjisë elektrike është çmimi më i lartë i Ofertës që i plotëson të gjitha kërkesat e tenderit. Më tej Pika 1 e nenit 13 specifikon që në rastet kur nuk është pranuar asnjë ofertë vlefshme për blerje/shitje afatshkurtër të energjisë elektrike, procesi i ofertimit do të përsëritet.

Kompania më qëllim të arritjes së çmimeve më të favorshme kishte përsëritur ankandet edhe në rastet kur ofertat ishin të vlefshme edhe pse procedura e ZRrE-së në rastet e tilla kërkon që të mos përsëritet ankandi. Si rezultat i përsëritjes së ankandeve, kemi identifikuar se në dy raste, kompania kishte kontraktuar çmime më të larta sesa çmimet në ankandet fillestare, po ashtu edhe në dy raste tjera kontraktimet ishin me çmime më të ulëta se sa çmimet nga ankandet fillestare.

Kjo ka ndodhur për shkak së kompania kishte vlerësuar së çmimet e ankandeve fillestare nuk ishin të favorshme.

##### Ndikimi

Si rezultat kompania për sasinë e njëjtë të energjisë së blerë ka paguar kosto më të lartë në krahasim me atë që do paguhej nëse do pranoheshin ofertat fillestare.

##### Rekomandimi A12

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë procedura të brendshme efektive për të arritur rezultatin maksimal të kompanisë dhe eliminimin e kostove më të larta në të ardhmen.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

#### Çështja A13 - Aktivitete të shpeshta të prokurimit me vlerë minimale

##### Gjetja

Autoriteti kontraktues nuk do të zgjedh ose përdor metodën e vlerësimit me qëllim të zvogëlimit të vlerës së kontratës për furnizim nën kufirin e caktuar në Nenin 19 të LPP., dhe asnjë autoritet kontraktues, nuk do të ndajë kërkesën për prokurim për një sasi të caktuar të produkteve me qëllim të zvogëlimit të vlerës së kontratës për furnizim nën kufirin e caktuar në nenin 19 të këtij ligji.

Kompania kishte zhvilluar gjithsej 208 aktivitete të prokurimit me vlerë minimale gjatë vitit 2022, kjo paraqet mbi 41% të gjithsej numrit të aktiviteteve të zhvilluara të prokurimit.

Kryesisht këto janë prokurime për:

- 22 kontrata për ujë të pijes dhe pije për bufe, në vlerë 14,166€, 18 prej të cilave nga i njëjti furnitor.
- 14 kontrata për furnizim me ngjitës, në vlerë 13,528€, 11 prej të cilave nga i njëjti furnitor.
- 10 kontrata për bateri të automjeteve, në vlerë 5,869€, 5 prej të cilave nga i njëjti furnitor.
- 8 kontrata për toner për printer, në vlerë 3,500€, 3 prej të cilave nga një furnitor dhe 3 tjera nga furnitori tjetër dhe
- 154 kontrata tjera të natyrave të ngjashme në vlerë 106,080€.

Sipas zyrtarëve të kompanisë, furnizimi me ngjitës me vlera minimale ishte për shkak se aktiviteti i prokurimit me procedurë të hapur i publikuar në vitin 2019 ishte pezulluar si pasojë e ankesës në OShP, e cila nuk ishte funksionale përgjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2022. Për aktivitetet tjera të prokurimit me vlera minimale kompania nuk ka ofruar ndonjë arsyetim.

#### **Ndikimi**

Ndarja e tenderëve në vlera të vogla dhe minimale ndikon në efikasitetin e zyrës së prokurimit, ngarkohet me numër më të madh të aktiviteteve. Gjithashtu ndarja mund të ndikojë në economicitetin e aktivitetit të prokurimit, çmimet e ofertave për sasi me të vogla mund të jenë më të larta se çmimet e ofertave për sasi më të mëdha.

#### **Rekomandimi A13**

Bordi i Drejtorëve të siguroj që kërkesat nga njësitë kërkuese grupohen në mënyrë që të zhvillojë më pak aktivitete të prokurimit që sigurojnë konkurrencë me të lartë dhe çmime më ekonomike.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

##### **Çështja A14 - Kërkesa të panevojshme në dosje të tenderit**

#### **Gjetja**

Sipas LPP, neni 7.3, Autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasi të ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik. dhe neni 7.4 Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

Për kontratën Furnizim me pjesë ndërrimi për eskavator (Liebherr), në vlerë prej 55,287€ e nënshkruar me datë 12.04.2022, kompania kishte kërkuar në dosje të tenderit, të kapaciteti teknik dhe profesional, që Operatori Ekonomik të sjellë "Autorizim, nga prodhuesi i pajisjes ose dileri i autorizuar, për produktet që ofroni". Njëri OE kishte kërkuar që të hiqet kjo kërkesë sepse në Kosovë ka vetëm një distributor të autorizuar për shitjen e pjesëve të Liebherr dhe asnjë OE tjetër nuk mund ta sigurojë këtë autorizim rrjedhimisht kompania ishte duke e favorizuar një OE të vetëm në çdo aktivitet prokurimi për këtë furnizim.

Në këtë tender kompania kishte refuzuar ankesën e OE-së dhe kishte vazhduar aktivitetin e prokurimit duke ia dhënë kontratën pikërisht OE-së për të cilin thuhej se është i vetmi që posedon autorizimin nga prodhuesi.

Megjithatë, Menaxhmenti kishte vendosur që në tenderët që zhvillohen pas datës 1 mars 2023 të mos aplikohet më kjo kërkesë.

Shkaku i aplikimit të kësaj kërkesë në dosje të tenderit ishte mos analizimi i kushteve të tregut nga ana e kompanisë.

**Ndikimi**

Vendosja e kërkesave të panevojshme ndaj operatorëve ekonomik, sidomos kur dihet se këto kërkesa e reduktojnë konkurrencën, mund të shkaktojë diskriminim mes operatorëve dhe mund të shpie në çmime jo-ekonomike.

**Rekomandimi A14**

Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj së nuk vendosen kërkesa e panevojshme në dosje të tenderit në mënyrë që të u jepet mundësi të gjithë operatorëve ekonomik të marrin pjesë në tender dhe të arrihen çmime ekonomike.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.5 Shpenzimet e pagave

Shpenzimet e pagave ishin 47,027,000€. Më 31 dhjetor 2022, Kompania ka pasur gjithsej 3,435 të punësuar. Gjatë vitit ishin punësuar 10 punonjës të rinj.

#### Çështja A15 - Mangësi në pagesat shtesë ndaj punëtorëve

##### Gjetja

Sipas Ligjit të punës nr.03/L-212, neni 55 paragrafi i katërt, Punëdhënësi duhet të nxjerrë një deklaratë për çdo pagesë dhe çdo shtesë tjetër të paguar të të punësuarve.

Gjithashtu, sipas Ligjit të punës nr.03/L-212, neni 56, punëtorëve ju takojnë paga shtesë në përqindje të pagës bazë, për punën më të gjatë se orari i plotë i punës, si dhe për punë në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës”.

Ne kemi vërejtur që kompensimet që lidhen për shujtat, kushtet e punës dhe pushimit nuk janë të bazuara në vendime të azhurnuara. Mangësitë janë si në vijim:

- Triskat në shumën 1.74 euro/ditë pune paguhen në bazë të çmimit të trashëguar nga marrëveshja me furnitorin Ushqimi sh.a., për shërbime të përgatitjes dhe furnizimit me ushqim për punëtorët e KEK e që nga data 26.05.2014 (kontratë e cila ka zgjatur për 24 muaj) dhe që nga ajo periudhë ky kompensim i punëtorëve nuk është aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.
- Kompensimi i pushimit 30 minuta gjatë punës i cili paguhet për punëtorët të cilët për shkak të natyrës së punës nuk lejohet të lëshojnë vendin e punës edhe gjatë pushimit, nuk është i aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.
- Shtesat për kushtet e punës paguhen bazuar në vendimin e UD Drejtorit Menaxhues të Kompanisë të datës 17.08.2007 sipas të cilit për shkak të kushteve të vështira punëtorëve të divizionit për prodhimin e qymyrit dhe divizionit të gjenerimit, paga mujore bazë e të cilëve nuk është më e lartë se 317 euro do të marrin shtesa për kushte të punës për 22 euro. Përkundër që sot paga mujore bazë 317 euro dhe kushtet tjera në bazë të cilave paguhen punëtorët kanë ndryshuar, këto nuk janë azhurnuar me një vendim të ri të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.
- Po ashtu, kemi vërejtur që punëtorët të cilët kanë punuar në ndërrimin e tretë dhe ditët e ndërrimit ishin fundjavë, janë kompensuar në përqindje të pagës bazë me normën 30% dhe jo 50% ashtu siç kërkohet me Ligjin e Punës dhe Kodin e Punës nenin 45 Pagesat shtesë. Vlen të theksohet se sipas evidencave të siguruara nga zyra ligjore, për këtë çështje punëtorët e kompanisë e kishin paditur kompaninë në vlerë prej 1.1 milion euro.

Kjo kishte ndodhur për arsye se Bordi i Drejtorëve nuk kishte azhurnuar dhe aprovuar vendimet në mënyrë që të reflektohen kushtet aktuale sipas të cilave kompensohen punëtorët.

##### Ndikimi

Mos aprovimi dhe mos azhurnimi me kohë i vendimeve lidhur me kompensimin e punëtorëve ka ndikuar që kompania të paditet në gjykata nga punëtorët e saj.




**Rekomandimi A15** Bordi i Drejtorëve të siguroj që të bëjë azhurnimin me kohë të vendimeve që lidhen me kompensimet e punëtorëve si dhe të siguroj që do të merren veprimet e nevojshme për azhurnimin e kontratave të punës ashtu që dispozitat e kontratave të mos jenë në kundërshtim me ligjin.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Auditimi për PFV-të e vitit 2021 të Ndërmarrjes Publike KEK sh. a. ishte kryer nga një kompani e kontraktuar e auditimit. Raporti i auditimit (Letër Menaxhmenti) për vitin 2021 të KEK sha kishte rezultuar me 21 rekomandime. Kompania kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022. Prej tyre katër (4) ishin zbatuar, 17 ishin në proces të zbatimit. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën në vijim.

**Grafiku 1. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 1 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Kontrollet e brendshme në raportimin financiar	Ne rekomandojmë Kompaninë që të shtohen kontrollat monitoruese aty ku mundësia e gabimit është më e madhe.	Gjatë auditimit, ne kemi identifikuar po ashtu raste të ngjashme, në zërat e pasqyrave financiare.	Pjesërisht i zbatuar
2.	Kontrollet e brendshme në raportimin financiar	Ne rekomandojmë Kompaninë që të vazhdojë të fuqizojë burimet dhe aftësitë e brendshme sa i përket raportimit të jashtëm financiar. Kompania duhet të merr në konsideratë edhe trajnimin e vazhdueshëm për kontabilitet pasi që Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar zhvillohen vazhdimisht. Në anën tjetër, duhet të përmirësohen proceset e brendshme të përgatitjes së pasqyrave financiare gjithëpërfshirëse dhe në kohë.	Kompania kishte ndërmarrë disa veprime gjatë vitit 2022 duke punësuar katër punonjës të rinj në departamentin e kontabilitetit duke përmisuar kështu proceset e brendshme të përgatitjes së raporteve financiare.	I zbatuar

3.	Kontrollet e brendshme në raportimin financiar	Ne rekomandojmë Kompaninë që raportet e tilla të jenë të finalizuara në momentin kur ato dërgohen tek Bordi i Drejtorëve për aprovim.	Edhe në vitin 2022 kompania kishte vonesa në finalizimin e raporteve të inventarizimit dhe Pasqyrat financiare vjetore.	Pjesërisht i zbatuar
4.	Kontrollet e brendshme në raportimin financiar	Ne rekomandojmë Kompaninë që të mirëmbajë dhe të përditësojë listën e çështjeve gjyqësore me të gjitha vendimet e fundit si dhe të përpilojë politikë për llogaritjen dhe njohjen e këtyre provizioneve. Ne poashtu rekomandojmë integrimin dhe transferimin e shënimeve nga Excel në programin financiar, ku do të mundësohen shënimet më të plota dhe më të sakta lidhur me rastet gjyqësore.	Rekomandimi është implementuar, është përditësuar lista e rasteve gjyqësore dhe të njëjtat janë njohur si obligime me 31 dhjetor 2022.	I zbatuar
5.	Llogaritë e arkëtueshme	Ne rekomandojmë që Kompania të shmang në maksimum vonesat në kryerjen e investimeve kapitale sipas afateve të kontraktuara.	Realizimi i projektit për ndërrimin e filtrave është shtyer nga BE, rrjedhimisht edhe realizimi i këtyre kontratave nuk ka qenë e mundur të bëhet.	Pjesërisht i zbatuar
6.	Stoqet	Ne rekomandojmë Kompaninë që të rishikojë mënyrën e menaxhimit të inventarit, duke filluar nga rishikimi i procedurave dhe proceseve të brendshme si dhe të bëhet avancimi i modulit të inventarit. Artikujt e identifikuar si të vjetëruara apo të ngadaltë duhet të ndahen. Kjo do të ndihmojë në uljen e niveleve të inventarit dhe do të përmirësojë gjendjen e depos. Ajo gjithashtu mund të rrisë produktivitetin e personelit të depos dhe të eliminojë mallin me afat të skaduar. Prandaj, inventari duhet të analizohet tërësisht, duke vlerësuar çdo artikull kundër përdorimit të pritshëm në të ardhmen.	Procesi i trajtimit të problemeve në menaxhimin e inventarit ka filluar dhe menaxhmenti ka për synim që një proces i ri i menaxhimit të inventarit do jetë në funksion pas implementimit të skemës së re organizative.	Pjesërisht i zbatuar

7.	Stoqet	Ne rekomandojmë që Kompania të bëjë rishikimin e procedurës së provizionimit të stoqeve në mënyrë që provizionimi të përcaktohet në bazë të disa parametrave specifik të stoqeve, si lëvizshmëria, afati i përdorimit, gjendja fizike etj. Ne rekomandojmë që për stoqet e vjetra dhe të dëmtuara për të cilat nuk pritet që të përdoren në periudhat e ardhshme të përcaktohet trajtimi i tyre i mëtjeshëm.	Kompania kishte formuar komisionet për evidentimin e stoqeve të papërdorshme dhe trajtimin e tyre mirëpo nuk kishte arritur të merrte aprovimin në Bord, për shlyerje nga librat kontabël për vitin 2022 dhe trajtim të mëtutjeshëm.	Pjesërisht i zbatuar
8.	Stoqet	Ne rekomandojmë që Kompania të fillojë një proces të unifikimit të nomenklaturave për të gjitha njësitë e saj në listat e stoqeve në mënyrë që jetë një sistem unik dhe të mundësojë identifikimin e lehtë të artikujve gjatë përdorimit apo numërimit të tyre. Po ashtu, ne rekomandojmë që depotë dhe ambientet të rregullohen në mënyrë që t'i mberojnë artikujt e stokut nga dëmtimet e ndryshme atmosferike, po ashtu artikujt të sistemohen nëpër rende dhe rafte të rregullta, në mënyrë që të identifikohen lehtësisht dhe të mundësojnë numërimin sa më të saktë.	Kompania kishte filluar zbatimin e rekomandimit.	Pjesërisht i zbatuar
9.	Pasuritë afatgjata	Ne rekomandojmë Kompaninë që përveç azhurnimit të regjistrit të saj të aseteve, të iniciojë dhe të zgjidh këtë çështje me autoritetet përkatëse sa më parë.	Kompania kishte themeluar një grup punues për evidentimin dhe sqarimin e pronësise se pronave të paluajtshme. mirëpo përditësimet me gjetjet e grupit punues ende nuk ishin reflektuar në regjistër të pasurisë.	Pjesërisht i zbatuar
10.	Pasuritë afatgjata	Ne rekomandojmë që Kompania të bëjë ndarjen e pasurive në momentin e regjistrimit të shtesave të pasurive fikse në mënyrë që jetëgjatësia e shtesave të pasurive fikse të jetë sa më e saktë.	Kompania kishte zbatuar regjistrimin e shtesave kapitale si pasuri e veçantë përmes procedurës së re për menaxhimin e pasurisë.	I zbatuar

11.	Detyrimet afatshkurta	Ne rekomandojmë që Kompania ta trajtojë këtë çështje me urgjencë në mënyrë që të eliminojë dënimet e mundshme tatimore në të ardhmen të vendosura nga autoritetet tatimore.	Kompania ka angazhuar një kompani për rishikimet tatimore. Gjendja e obligimeve tatimore në kontabilitet për vitin 2022 përputhej me gjendje e llogarive tatimore në ATK.	I zbatuar
12.	Të hyrat	Ne rekomandojmë që procedurat të dokumentohen dhe të pëcaktohen në një manual që gjithashtu duhet të tregojë caktimin e detyrave për departamentet ose punonjësit individualë të cilët merren me eksport të energjisë. Poashtu ne rekomandojmë Kompaninë që të gjitha departamentet dhe funksionet e Kompanisë të kenë procedurat dhe manualët e punës si dhe të bëhet azhurnimi në baza të rregullta kohore së paku një herë në vit.	Procedura nuk është aprovuar deri në datën e raportimit.	Pjesërisht i zbatuar
13.	Shpenzimet e pagave	Kompania duhet të respektojë në plotëni ligjet, politikat, procedurat e brendshme si dhe vendimet tjera për personelin që aprohen nga Bordi Drejtues i Kompanisë. Ne rekomandojmë që të bëhet rishikimi i dosjeve të punëtorëve dhe të bëhet plotësimi i tyre.	Ky proces do realizohet pas fazës së rishikimit funksional të kompanisë.	Pjesërisht i zbatuar
14.	Shpenzimet e pagave	Ne rekomandojmë Kompaninë që të gjitha departamentet dhe funksionet e biznesit të kenë procedurat dhe manualët e punës si dhe të bëhet azhurnimi në baza të rregullta kohore së paku një herë në vit.	Kompania ka arritur ta implementojë vetëm pjesërisht rekomandimin për përgaditjen e manualeve dhe procedurave të brendshme.	Pjesërisht i zbatuar
15.	Sistemet Informative	Ne rekomandojmë Kompaninë që të shikojë mundësitë e avancimit të softuerit i cili përdoret aktualisht, apo të pajiset me ndonjë softuer të ri i cili do t'i plotësojë të gjitha kërkesat si pjesën financiare ashtu edhe menaxheriale.	Është nënshkruar kontrata me kompaninë e cila do mirëmbajë sistemin dhe njëkohësisht do migrojë shënimet e inventarit tek moduli i Oracle.	Pjesërisht i zbatuar

16.	Sistemet Informative	Ne rekomandojmë që Kompania: të përcaktojë dhe definojë të drejtat dhe përgjegjësitë e stafit në softuerin e ri; të vazhdojë me kujdes të shtuar fazën e futjes në përdorim dhe t'i shfrytëzojë të gjitha funksionet e tij; të ofojë trajnimet e duhura stafit në përdorim dhe shfrytëzim të softuerit; të gjej mënyrën më të mirë të mirëmbajtjes dhe zhvillimit të mëturjes.	Në proces të implementimit.	Pjesërisht i zbatuar
17.	Sistemet Informative	Ne rekomandojmë që të kriptoni të gjitha disqet e pajisjeve në pronësi të korporatës, veçanërisht ato që përdoren jashtë rrjetit të KEK-ut.	Është definuar në draft Politikën e reja të SI-se që janë dërguar në Bord për aprovim vitin e kaluar.  Pritet aprovimi nga Bordi i Drejtorëve.	Pjesërisht i zbatuar
18.	Sistemet Informative	Ne rekomandojmë që të kërkonin raporte të rregullta me shkrim nga stafi i TIK në lidhje me testet e rikthimit të të dhënave dhe sistemeve kritike të korporatës.	Është definuar në draft Politikën e reja të SI-së që janë dërguar në Bord për aprovim vitin e kaluar.  Pritet aprovimi nga Bordi i Drejtorëve.	Pjesërisht i zbatuar
19.	Sistemet Informative	Ne rekomandojmë që të specifikoni qartë periudhat kohore për çdo procedurë dhe rishikoni nëse ekziston nevoja për të përgatitur dokumente të tjera mbështetëse siç janë: Udhëzimet për reagim në raste të emergjencave, Plani i Vazhdimësisë së Biznesit, Plani i Rimëkëmbjes në rast të katastrofës, procedurat shpesh për testet e rikthimit etj.	Është definuar në draft Politikën e reja të SI-së që janë dërguar në Bord për aprovim vitin e kaluar.  Pritet aprovimi nga Bordi i Drejtorëve.	Pjesërisht i zbatuar
20.	Sistemet Informative	Ne rekomandojmë menaxhmentin e TIK për të rishikuar nëse kjo praktikë duhet të lejohet. Kufizimi i qasjes. Proxy i brendshëm dhe filtrimi i përmbajtjes janë masa të rëndësishme të sigurisë për të minimizuar ekspozimin ndaj sulmeve që vjen nga rrjeti i brendshëm i korporatës.	Është draftuar politika dhe është në pritje të aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.	Pjesërisht i zbatuar
21.	Sistemet Informative	Ne rekomandojmë kontraktimin e një kompanie të specializuar në sigurinë e TIK për të testuar rrjetet dhe sistemet e TIK të KEK për ndonjë cenueshmëri. Nëse ka ndonjë të tillë, kërkonin rekomandime profesionale se si t'i përmirësoni ose rregulloni ato.	Kompania nuk ka rritur ta implementojë rekomandimin për këtë çështje.	Pjesërisht i zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Naser Arllati, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Mehmet Mucaj, Drejtor i Auditimit



Naim Neziri, Udhëheqës i ekipit



Egzona Maqedonci, Anëtare e ekipit



Besim Lezi, Anëtar i ekipit



Arben Selimi, Anëtar i ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi / Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit

Çështja	Komenti i NP-së	Pikëpamja e ZKA-së
Përsëritja e ankandeve jo në pajtim më procedurën e ZRRE-së për tregtim të energjisë	Procedura e Tregtimit të Energjisë Elektrike e ZRRE-së nuk e ka paraparë rastin konkret për përsëritjen e ankandeve në rastet kur kishte ofertat valide por që nga menaxhmenti nuk janë konsideruar ofertat e përshtatshme duke u bazuar në çmimet e tregut. Procedura e ZRRE-së nuk e kufizon që në raste të tilla nuk duhet të përsëriten ankandet kur ofertat nuk janë të favorshme. Për më tepër në mbështetje të veprimeve të KEK-ut, në të shumtën e rasteve përsëritja e ankandeve ka rezultuar e suksesshme dhe në favor të KEK-ut. Përsëritja e ankandeve ka ndodhur zakonisht kur çmimet e ofertuara kanë qenë dukshëm më të ulëta (apo më të larta në rastin e blerjes) se çmimet e tregut dhe çmimet e pritura bazuar në parashikimet tona.	Komenti nuk është relevant dhe gjetja qëndron. Çështja është trajtuar bazuar në Procedurën për Tregtimit të Energjisë Elektrike të ZRRE-së. Përsëritja e ankandeve kishte ndodhur jo në pajtim me nenin 13.1 cili përcakton se “Në rastet kur nuk është pranuar asnjë Ofertë valide për Blerje/Shitje afatshkurtë të energjisë elektrike, procesi i ofertimit do të përsëritet”.
Mos rivlerësimi periodik i pasurive afatgjata	Qasja e bazuar ne Kosto: Metoda e rivlerësimit përfshin vlerësimin e asetëve me vlerën e tyre të drejtë, e cila mund të mos jetë praktike ose domethënëse për lloje të caktuara asetesh, si termocentralet dhe pajisjet e përdorura në prodhimin e energjisë elektrike që janë të specializuara dhe unike për industrinë, duke e bërë të vështirë, pothuajse të pamundur, përcaktimin e saktë të vlerës së tyre të drejtë. Në raste të tilla, një qasje e bazuar në kosto, ofron informacion më të besueshëm dhe më të përshtatshëm për raportimin financiar. Luhatshmëria: Metoda e rivlerësimit mund të sjellë paqëndrueshmëri në PF. Ndryshimet e vlerës së drejtë, veçanërisht për aktivet me jetëgjatësi si TC, mund të luhaten për shkak të ndryshimeve në kushtet e tregut, përparimeve teknologjike ose faktorëve rregullator. Këto luhatje mund të shtrembërojnë performancën financiare të	Komenti nuk është relevant dhe gjetja qëndron.  Meqenëse kompania në Pasqyrat Financiare tek shënimi shpjegues 2.6 - Prona, impiantet dhe pajisjet ka shpalosur se zërat e pronave, impianteve dhe pajisjeve më 01 janar 2005 janë ri paraqitur me koston e konsideruar pra pasuritë janë ri prezantuar sipas vlerës së drejtë të tregut me metodën e koston së zëvendësimit bazuar në Raportin e Vlerësimit të Pasurisë të datës 31 dhjetor 2004 nga vlerësuesi i pavarur “American Appraisal Hungary Co. Ltd”. Ndërsa zërat e pronës, impianteve edhe pajisjeve të blera/ përvetësuar pas datës 01 janar 2005 paraqiten me koston e blerjes apo përvetësimit.  Tutje, në regjistrin e pasurisë të datës 31 dhjetor 2022 kompania kishte gjithsej pasuri afatgjatë në



kompanisë dhe ta bëjnë të vështirë për palët e treta të vlerësojnë përfitimin e vërtetë themelor të kompanisë.

Mjedisi Rregullator: Kompanitë e prodhimit të energjisë operojnë në një mjedis të rregulluar, ku tarifat dhe të ardhurat përcaktohen nga organet rregullatore bazuar në formula të paracaktuara ose mekanizma të mbulimit të kostos. Edhe pse në formë indirekte KEK, metoda e rivlerësimit mund të mos përputhet me kuadrin rregullator dhe aplikimi i matjeve të vlerës së drejtë mund të rezultojë në një mospërputhje midis vlerave të raportuara dhe kërkesave rregullatore që mund të krijojë konfuzion dhe të pengojë krahasueshmërinë me ndërmarrjet tjera të industrisë.

Sfidat praktike: Zbatimi i metodës së rivlerësimit kërkon ekspertizë të konsiderueshme, burime dhe vlerësime të vazhdueshme. Kërkon angazhimin e ekspertëve të jashtëm, kryerjen e vlerësimeve të rregullta dhe mbajtjen e modeleve komplekse të vlerësimit. Për kompanitë e prodhimit të energjisë elektrike është sfidë operacionale dhe e kushtueshme aplikimi i vazhdueshëm i metodës së rivlerësimit të asetëve, veçanërisht duke marrë parasysh natyrën e specializuar të infrastrukturës së tyre dhe natyrën dinamike të industrisë. Menaxhmenti, në përputhje me SNRF në baza të rregullta vjetore ka kryer testimin e asetëve për dëmtim. Bazuar në këto testime vlera neto e asetëve nuk dallon materialisht nga fitimi neto që pritet të gjenerohet ndër vite që lë të nënkuptojë që asetet prezantojnë vlerën e tyre reale dhe që nuk ka nevojë të kryhen korrigjime në vlerën bartëse të tyre. Tutje, KEK është në fazën e realizimit të investimeve kryesore, përfshirë rehabilitimin dhe modernizimin e njësisve B1 dhe B2, rehabilitimin e njësisve të TCA, investimet në miniera, ndërtimin e parkut solar me kapacitet 100 MW etj, të cilat në total pritet të arrijnë

vlerë kontabël neto prej 227 milion euro. Prej tyre 22 milion euro janë pasuri që mbahen sipas modelit të rivlerësimit, vlera e drejtë e tregut e caktuar në raportin e Vlerësuesit të pavarur American Appraisal Hungary CO. Ltd. të datës 31 dhjetor 2004.

Pra për vlerën prej 22 milion euro, kompania nuk kishte kryer rivlerësimet periodike që nga viti 2005. Në konsiderojmë se vlera e drejtë e tregut që nga viti 2004 për pasuritë ka ndryshuar materialisht.

Për më tepër në regjistër mbahen pasuri me vlera si: 50 cent për 12.8 hektar tokë, 50 cent për 16 ari, 1 euro 22 hektar, banesë në Prishtinë 52m<sup>2</sup> vlera në regjistër 5,790 euro. Po ashtu ka edhe disa pjesë të impianteve si Stabilimentet shpërndarëse, fusha hyrëse dhe dalje 6 KV me vlerë hyrëse të regjistruar me zero dhe vlerë kontabël neto zero. Prandaj ne besojmë së rekomandimi i dhënë do të adresonte çështjen e ngritur në raport.

Në rastet kur vlera neto e pasurisë është zero (0.00) por Menaxhmenti ka njohuri që vlera në treg e asaj pasurie është më e madhe se zero atëherë Menaxhmenti duhet të angazhojë vlerësues të pavarur për të vlerësuar vlerën e drejtë të këtyre asetëve (do të thotë duhet të aplikohet qasja e vlerës së drejtë dhe jo sipas kostos).

Duke pasur parasysh se këto pasuri janë në përdorim (sipas raportit të komisionit të inventarizimit) dhe kompania merr përfitime ekonomike nga përdorimi i këtyre pasurive sipas kërkesave të standardeve duhet që të përdoret parimi i përputhjes duke njohur edhe shpenzimet e zhvlerësimit për ato pasuri që krijojnë të hyra nga përdorimi i tyre.

	<p>vlërën mbi 600 milion EUR, dhe në këtë fazë të investimeve çdo ri vlerësim i kryer paraqet kosto shtesë të pa arsyeshme duke pasur në konsideratë faktin që ne veç do kemi një kosto të datës së realizimit të investimit.</p> <p>Gjithsesi KEK pajtohet për ri vlerësimin e kategorisë së tokave.</p> <p>Lidhur me 75% të numrit të aseteve me vlerë kontabël zero, SNRF nuk kërkon që vlera kontabël e një aseti të mbahet në një shumë pozitive për sa kohë që ajo paraqitet dhe shpaloset në mënyrë të përshtatshme në PF. Është thelbësore të jepet informacion shpjegues për ekzistencën dhe natyrën e aseteve të tilla, duke përfshirë vlerën kontabël të tyre dhe çdo zhvlerësim të lidhur, në shënimet e pasqyrave financiare.</p> <p>Asetet me vlerë kontabël zero mund të jenë ende në përdorim, KEK ka kosto të mirëmbajtjes për këto aseteve, dhe kjo kosto përkon më të hyrat që realizohen nga përdorimi i aseteve me vlerë kontabël zero, për më tepër që 77% e vlerës se këtyre aseteve janë asete të cilat duhet të kenë vlerën neto zero. Prandaj, duke parasysh SNK/SNRF dhe specifikat e KEK-ut, menaxhmenti konsideron që kjo gjetje nuk qëndron dhe njëkohësisht është rekomandim i cili nuk është praktikisht i zbatueshëm tek pajisjet e prodhimit.</p>	
<p>Mos prezantimi i plotë i informacioneve shpjeguese për kontingjencat</p>	<p>Menaxhmenti ka shpalosur dhe ka kryer të gjitha vlerësimet në lidhje me provizionet, detyrimet dhe pasuritë kontingjente bazuar në informacionin të cilin e ka poseduar në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare. Për më tepër, në shënimin 3 të pasqyrave financiare menaxhmenti ka konstatuar që në vlerësimet e kryera ka pasiguri dhe që ka një rrezik të konsiderueshëm për të shkakuar një rregullim material të mbajtjes së pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar.</p> <p>Detyrimet kontingjente janë të pasigurta nga natyra. Nëse ka pasiguri të konsiderueshme rreth</p>	<p>Komenti nuk është relevant dhe gjetja qëndron.</p> <p>Shpalosjet për detyrimet dhe pasuritë kontingjente nuk janë të plota. Para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore kompania ishte në dijeni për shkeljet e konstatuara nga rregullatori dhe rastet e fituara në gjykatë për pronat e paluajtshme.</p> <p>Sa i përket gjobës prej 3.2 milion euro, të datës 05 maj 2023 të vendosur nga rregullatori, procesi i monitorimi kishte filluar në maj 2022 dhe me 17 nëntor 2022, rregullatori përmes raportit të monitorimit kishte konstatuar shkeljet. Pas trajtimit të</p>

mundësisë së materializimit të detyrimit ose shumës së përfshirë, dhënia e informacioneve shpjeguese mund të mos jetë e nevojshme. SNK 37, i cili trajton provizionet, pasuritë kontigjente dhe detyrimet kontigjente, thekson së dhënia e informacioneve shpjeguese e një detyrimi kontigjent nuk kërkohet nëse probabiliteti i një daljeje burimesh është e pasigurtë. KEK zhvillon veprimtari të njëjtë te tregtimit me energji nga viti 2013 e tutje, nga viti 2019 kur edhe ka filluar procesin e eksportit, KEK në baza të rregullta mujore ka njoftuar ZRRE për të gjithë veprimtarinë e kryer në tregtim të energjisë dhe duke pasur parasysh faktin që KEK nuk është ndëshkuar asnjë herë për cilin do transaksion apo veprimtari të zhvilluar, menaxhmenti ka konsideruar që shkeljet e konstatuara për herë të pare nga ZRRE do mbesin vetëm si vërejtje dhe se KEK do i jepet kohe për ti adresuar implementimin e të njëjtave.

Zyra Ligjore ka parashtruar padi me datë 16.06.2023 në Departamentin Administrativ të Gjykatës Komerciale duke i propozuar Gjykatës anulimin e vendimit të ZRRE-së me të cilin KEK-ut i është shqiptuar dënim me gjobë.

Prandaj lidhur me këtë çështje menaxhmenti konsideron se autoritet vendimtar për të përcaktuar nëse dënimi i shqiptuar nga ZRRE është i drejtë dhe Ligjor, janë Gjykatat kompetente në Kosovë. Ne konsiderojmë se në asnjë mënyre nuk duhet të paragjykohet vendimi i organeve të drejtësisë të cilave ne si KEK kemi besimin e plotë lidhur me këtë procedurë kontestimore.

Për sa i përket asetëve kontigjente dhe shpalosjeve të tyre kjo ka qenë e pamundur të kryhet pasi në kohën e përgatitjes së pasqyrave financiare nuk ka qenë e mundur të bëhet një vlerësim i përfitimeve ekonomike nga asetet kontigjente, për më tepër që vlera e tyre nuk është materiale

komenteve të kompanisë më 24 shkurt 2023, kompania kishte pranuar njoftimin për shkeljet e konstatuara ku edhe ishte njoftuar se do të aplikohen dispozitat e masave ndëshkimore ashtu siç parashihet me legjislacionin në fuqi.

Poashtu për pasuritë kontigjente kompania gjatë marsit 2023 kishte pranuar aktgjykimet në favor të tyre.

Meqenëse, kompania për këto fakte ka qenë në dijeni para përgatitjes së pasqyrave financiare dhe mundësia e daljes së parasë dhe përfitimeve ekonomike ekziston atëherë Menaxhmenti do të duhej të kryente vlerësimet e duhura për këto raste dhe të jepte informacione për to në shënime shpjeguese.

	<p>dhe si e tille nuk duhet të ketë ndikim në opinionin e dhënë mbi pasqyrat financiare.</p>	
<p>Mos përputhje e detyrimeve në regjistrat kontabël të kompanisë më gjendjen tek furnitorët</p>	<p>Konstatimi që llogaritë e pagueshme janë të nënvlerësuara nuk qëndron, kualifikimi për çështjen që regjistrat nuk përputhen me shënimet e furnitorëve është i pa baze për me tepër duke pasur në konsideratë faktin që jo domosdoshmërisht regjistrat e furnitorëve paraqesin një gjendje më reale se sa ajo që KEK posedon.</p> <p>Borxhi i kontestuar me KOSTT ka bazë juridike mbi të cilën nuk është pranuar, sepse problemi ka ndodhur në pjesën e aseteve të KOSTT dhe çështja nuk është vendosur akoma as nga shkalla e parë e shqyrtimit (ZRRE), prandaj KEK beson që vendimi final do të jetë në favor të KEK-ut dhe që nuk do të ketë dalje të parasë për këtë çështje. Prandaj, bazuar në SNRF-të, ky nuk konsiderohet obligim i KEK-ut dhe si i tillë nuk është përfshirë në pasqyrat financiare. Për më tepër, rasti i kontestit të faturës së KOSTT është specifik dhe si i tillë nuk trajtohet me procedurën aktuale për mbulimin e jo balancave në treg.</p> <p>Borxhi tek KRU Prishtina është borxh i kontestuar, kartelat financiare të KEK-ut barazohen me ato të KRU Prishtina për subjektet e faturuara të cilat janë në pronësi të KEK-ut prandaj KEK refuzon të njohë obligimet për subjektet që nuk menaxhohen dhe as nuk janë në pronësi të KEK-ut. Kjo çështje është adresuar edhe tek KRU Prishtina.</p> <p>Prandaj, duke pasur parasysh faktet më larte, ne konsiderojmë që ky kualifikim është i pa qëndrueshëm dhe si i tillë duhet të largohet nga baza për opinion, dhe mbi të gjitha nuk është material për pasqyrat financiare.</p> <p>Për më tepër KEK do të veproj konform të drejtave të saj si NP në drejtim të kontestimit të çështjeve për të cilat nuk pajtohet me operatorët tjerë të biznesit duke</p>	<p>Komenti nuk është relevant dhe gjetja qëndron.</p> <p>Sa i përket faturës ndaj KOSTT, konsiderojmë se duhet të njihet në përputhje me Rregullat e Tregut, e cila është specifikuar në kuadër të gjetjes.</p> <p>Sa i përket diferencave tek KRU” Prishtina” dhe KRM ” Pastrimi”, Kompania nuk kishte kryer barazimet me këta furnitor për të përcaktuar gjendjen e saktë me 31 dhjetor 2022.</p> <p>Vlen të ceket se këto mos barazime rrjedhin nga faturimet e rregullta mujore me specifikacione për secilën njësi të cilat nëse kompania pretendon se nuk i takojnë do të duhej të harmonizohej me kohë me furnitorët dhe të paraqiste gjendjen ashtu siç ishte me 31 dhjetor 2022.</p> <p>Për më tepër, ne kemi pranuar konfirmimet bashkë me detajet e specifikacioneve të faturave nga KRU Prishtina sh.a. dhe KRM Pastrimi sh.a. dhe për diferencat, kompania gjatë kohës sa ishim në auditim është shprehur se nuk është në dijeni dhe nuk ka ofruar sqarime shtesë. Kompania ka filluar procesin e barazimit me këta dy furnitor me 13 qershor 2023, pas finalizimit të pasqyrave financiare dhe përfundimit të auditimit.</p>

	<p>adresuar konfliktet administrative tek Gjykatat kompetente. Prandaj në asnjë mënyre nuk guxojmë të paragjykojmë apo të lëshohemi në interpretim të çështjeve të cilat ju takojnë organeve të drejtësisë.</p>	
<p>Politikë e papërshtatshme për provizionimin e stokeve</p>	<p>Konstatimi që KEK ka aplikuar një Politikë te papërshtatshme për provizionimin e stokeve është i pa qëndrueshëm dhe nuk bazohet në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare te Kontabilitetit. Vlerësimi mbi politikën e provizionimit të stokeve është vlerësim i brendshëm i menaxhmentit, në përputhje me kërkesat e SNRF-ve dhe i bazuar në një historik mbi 10 vite të qarkullimit të stokeve, vlerësim ky i cili ka rezultuar me një prezantim real të gjendjes së stokeve në fundvit dhe shpenzimeve për provizionet për stoke te ngadalshme dhe të vjetërsuara.</p> <p>Për më tepër, konstatimi qe aplikimi i vlerësimit është kryer pa u bere grupimi i artikujve prapë nuk qëndron, artikujt e mbajtur në stoke janë të gjitha te grupuara sipas kategorisë se cilës i takojnë, për me tepër duhet pasur parasysh qe kërkesat e standardeve për grupime te artikujve ndërlidhen me vlerësimin e vlerës fer të artikujve në rastet kur stoqet mbahen për shitje, rast ky i cili nuk aplikohet për KEK-un.</p> <p>Menaxhmenti ka aplikuar vazhdimisht të njëjtën metodologji dhe teknika vlerësimi për provizionimin e inventarit në periudhat e mëparshme, kjo tregon një historik dhe konsistencë në qasjen tonë. ZKA duhet të marr në konsideratë zbatimin historik të metodologjisë dhe të vlerëson nëse ndonjë ndryshim në qasje është i justifikuar apo i arsyeshëm. Pasi metodologjia është zbatuar vazhdimisht dhe ka dhënë rezultate të besueshme në të kaluarën, atëherë ju nuk mund ta kualifikoni qasjen tonë pa fakte të mjaftueshme që kjo metodologji ka qenë e pasakte dhe ka rezultuar me</p>	<p>Komenti nuk është relevant dhe gjetja qëndron.</p> <p>Kompania në regjistrin e stokeve ka 32,793 artikuj të ndryshëm (si dhëmbëzor, kushineta, gypa të çelikut, dizne, pompa hidraulike, drita sinjalizuese, veshje pune etj.) në vlerë bruto prej 52 milion euro te cilat pas provizionimit ndër vite prej 40 milion euro me 31 dhjetor 2022 kanë vlerë neto 12 milion euro.</p> <p>Provizionimi i njohur për vitin 2022 ishte 216 mije euro.</p> <p>Kompania njeh humbje poshtë kosos se blerjes për të gjitha stoqet që janë më të vjetra se 100 ditë nga data e blerjes pra bazuar vetëm në kriterin e vjetërsisë (ditët e qëndrimit të stokut në depo) pa bërë grupime të artikujve sipas faktorëve specifik të grupeve siç mund të jenë: afati i përdorimit, gjendja fizike e tyre, pritshmëria e kohës së futjes në përdorim e tjera.</p> <p>Prandaj konsiderojmë se duke pasur parasysh lloj llojshmërinë e artikujve duhet që të aplikohen norma të përshtatshme sipas specifikave të grupeve dhe jo të gjitha grupet/artikujt të zhvlerësohen me normën 80%.</p>

	<p>vlërësime të gabuara.</p> <p>Metodologjia dhe teknikat e vlerësimit shpalosen në mënyrë transparente dhe në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe raportimit financiar dhe në asnjë rast nuk mund të kualifikohet qasja e menaxhmentit nëse nuk ka dëshmi të qarta që metodologjia është e pasaktë, e pabesueshme ose në kundërshtim me kërkesat e standardeve të kontabilitetit.</p>	
Vonesat në aprovimin e pasqyrave financiare	<p>Raportimi financiar i kompanive është i rregulluar specifikisht me ligjin për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, dhe kërkesat e këtij ligji i mbizotërojnë te gjitha kërkesat e ligjeve tjera që ndërlidhen me raportimin financiar, ligj ky i cili në nenin 17 parasheh:</p> <p>Neni 17, Afatet kohore për dorëzim dhe publikimi i pasqyrave financiare 1. Pasqyrat financiare të shoqërive tregtare që auditohen në pajtim me SNA-të dhe në pajtim me nenin 7, paragrafi 1., dhe nenin 8, paragrafi 1. të këtij Ligji, dorëzohen dhe publikohen në KKRF dhe një kopje dorëzohet në ministrinë përkatëse për tregti dhe industri, jo më vonë se më 30 prill të vitit vijues.</p> <p>Prandaj, KEK konsideron që pasqyrat financiare janë përgatitur dhe aprovuar sipas kërkesave ligjore.</p>	<p>Çështja lidhur me vonesat në aprovimin e pasqyrave financiare është trajtuar duke iu referuar Ligjit Për Ndërmarrje Publike, neni 31.3, prandaj komenti i bërë nga entiteti nuk përkon me çështjen të cilën e kemi trajtuar në raport.</p> <p>Gjetja mbetet e pa ndryshuar.</p>



KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS sh.a.  
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C  
KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d.



## LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kemi pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Korporatës Energjetike të Kosovës sh. a., për vitin 2022 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet dhe komentet për përmbajtjen e Raportit janë përcjellur në dokumentin e bashkangjitur si shtojca A.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, KEK do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve për të cilat KEK është pajtuar t’i implementojë, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Skender Haziri

Kryesues i Bordit të Korporatës Energjetike të Kosovës sh. a.,

Data: 22 Qershor 2023.





## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante.
- <sup>2</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet



**Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A.**

**Pasqyrat Financiare për vitin që  
përfundon më 31 Dhjetor 2022**



KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.  
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.  
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

## Statement of Compliance

For the financial statements as at December 31,  
2022

We declare that the financial statements as at and for the year ended December 31, 2022 give true and fair view of the financial position, financial performance, and cash flows and that the financial statements have been prepared in accordance with all requirements of *Law 06 / L-032 on Accounting, Financial Reporting and Auditing*.

Z. Përparim Kabashi  
UD Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv

## Deklaratë e Pajtueshmërisë

Për pasqyrat financiare që përfundojnë më 31  
dhjetor 2022

Deklarojmë që pasqyrat financiare për vitin raportues që përfundon më 31 dhjetor 2022 paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve, dhe rrjedhave të parasë dhe që pasqyrat financiare janë përgaditur në pajtim me të gjitha kërkesat e *Ligjit 06/L-032 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim*.

Z. Gramos Hashanaj  
Zyrtar Kryesor i Financave dhe  
Thesarit

Prishtinë  
27 Prill 2023

**PËRMBAJTJA**


**FAQE**

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR 1	1
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	8
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	9
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	10
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	11
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINANCIARE	12 – 51

**KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.**  
**Pasqyra e Pozicionit Financiar**  
**Më 31 Dhjetor 2022**

Shënimet	Më 31 Dhjetor 2022 (në EUR '000)	Më 31 Dhjetor 2021 (në EUR '000)	Riparaqitur 1 Janar 2021 (në EUR '000)	
<b>PASURITË</b>				
<b>Pasuritë afatgjata</b>				
Prona, impiantet dhe pajisjet	4	232,734	270,902	296,365
Depozitat ne banka - pjesa afatgjate	9	96,900	-	-
Pasuritë e paprekshme	5	618	848	221
<b>Gjithsej Pasuritë afatgjata</b>		<b>330,252</b>	<b>271,750</b>	<b>296,586</b>
<b>Pasuritë afatshkurtra</b>				
Inventarët	6	20,831	20,289	19,841
Të arkëtueshmet tregtare dhe tjera, neto	7	77,954	54,677	40,850
Paraja në dorë dhe në bankë	8	97,127	112,517	67,928
Depozitat ne banka - pjesa afatshkurtër	9	48,500	-	-
Të arkëtueshmet e shtyera të prodhimit të energjisë		2,313	-	-
<b>Gjithsej Pasuritë afatshkurtra</b>		<b>246,725</b>	<b>187,483</b>	<b>128,619</b>
<b>GJITHSEJ PASURITË</b>		<b>576,977</b>	<b>459,233</b>	<b>425,205</b>
<b>EKUITETI DHE DETYRIMET</b>				
<b>Ekuiteti i aksionarëve</b>				
Kapitali aksionar	10	25	25	25
Rezervat	11	198,472	197,848	197,467
Fitimet / (Humbjet) e akumuluar		114,208	9,091	(20,086)
<b>Gjithsej ekuiteti i aksionarëve</b>		<b>312,705</b>	<b>206,964</b>	<b>177,406</b>
<b>Detyrimet</b>				
<b>Detyrimet afatgjata</b>				
Huazimet - pjesa afatgjatë	12	115,380	126,767	138,154
Grantet e shtyera	13	8,211	10,820	16,156
Provizionet	14	56,193	55,677	48,561
Detyrimet e tatimit të shtyrë	25	9,648	10,770	10,820
		<b>189,432</b>	<b>204,034</b>	<b>213,691</b>
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>				
Huazimet - pjesa afatshkurtër	12	12,026	12,015	12,051
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	15	21,455	7,522	13,799
Tatimi mbi të ardhura i pagueshëm		7,759	4,569	613
Grantet e shtyera - Importi i Energjisë	13.1	27,012	16,648	-
Shpenzimet akruale	16	6,587	7,481	7,645
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurtra</b>		<b>74,840</b>	<b>48,235</b>	<b>34,108</b>
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>264,272</b>	<b>252,269</b>	<b>247,799</b>
<b>Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet</b>		<b>576,977</b>	<b>459,233</b>	<b>425,205</b>

Këto pasqyra financiare janë të autorizuara për lëshim nga Bordi i Drejtorëve dhe të nënshkuara në emër të tyre më 27 prill 2023:



**Z. Përparim Kabashi**  
 UD Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv



  
**Z. Gramos Hashani**  
 Zyrtar Kryesor i Financave dhe Thesarit

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shoqëruese të faqeve 12 deri 51 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

**KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.**  
**Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse**  
**Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022**

Shënimet	Viti i përfunduar 31 Dhjetor 2022 (në EUR '000)	Viti i përfunduar 31 Dhjetor 2021 (në EUR '000)	
Të hyrat nga shitja e rrymës	17	283,517	216,607
Të hyrat nga grantet	18	22,245	8,688
Të hyrat tjera	19	2,199	1,352
		<b>307,961</b>	<b>226,647</b>
<b>SHPENZIMET OPERATIVE</b>			
Zhvlërësimi dhe amortizimi	4,5	(48,462)	(57,278)
Shpenzimet e personelit	20	(47,027)	(50,728)
Energjia elektrike dhe komunalitë	21	(53,025)	(26,614)
Kostot e mirëmbajtjes		(3,888)	(4,546)
Materialet dhe furnizimet		(4,963)	(4,091)
Shpenzimet e linjtit		(25,071)	(14,792)
Provizionimet për shlyerjen e inventarit		(216)	(1,353)
Humbjet nga zhvlërësimi/Lirimi i të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera		(4,500)	(3,647)
Ndryshimi në provizione	14	423	(6,507)
Shpenzimet e shtyera të prodhimit të energjisë		2,367	-
Shpenzimet e tjera operative	22	(6,551)	(6,619)
		<b>(190,913)</b>	<b>(176,175)</b>
<b>Fitimi nga operacionet</b>		<b>117,048</b>	<b>50,472</b>
Te hyrat / (Shpenzimet) financiare, neto	23	1,694	(3,250)
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>118,742</b>	<b>47,222</b>
Shpenzimet e tatimit në fitim	24	(13,625)	(8,045)
<b>Fitimi neto për vitin</b>		<b>105,117</b>	<b>39,177</b>
<b>Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>			
<b>Zërat që nuk do të riklasifikohen në fitim dhe humbje</b>			
Efekti i tatimit të shtyer në rivlerësimin e pronës, impianteve dhe pajisjeve	25	624	381
<b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>105,741</b>	<b>39,558</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shoqëruese të faqeve 12 deri 51 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare

**KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS SH.A.**

**Pasqyra e ndryshimeve në Ekuifet**

**Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022**

	Kapitali aksionar (në EUR '000)	Rezervat (në EUR '000)	(Humbjet)/Fitimet e akumuluar (në EUR '000)	Gjithsej (në EUR '000)
<b>Gjendja më 01 Janar 2021</b>	25	568,784	(391,403)	177,406
Gjendja e riparqitur me 01 Janar 2021	25	197,467	(20,086)	177,406
Transaksionet me pronarët	-	-	-	-
Dividenda e paguar	-	-	-	-
Transaksionet me pronarët	-	-	(10,000)	(10,000)
Fitimi i vitit	-	-	(10,000)	(10,000)
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	39,177	39,177
Gjithsej të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	381	-	381
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2021</b>	25	197,848	39,177	39,558
			9,091	206,964
<b>Gjendja më 01 Janar 2022</b>	25	197,848	9,091	206,964
Transaksionet me pronarët	-	-	-	-
Transaksionet me pronarët	-	-	-	-
Fitimi i vitit	-	-	105,117	105,117
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	624	-	624
Gjithsej të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	624	105,117	105,741
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2022</b>	25	198,472	114,208	312,705

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shoqëruese të faqeve 12 deri 51 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare

**KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.**  
**Pasqyra e rrjedhës së parasë**  
**Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022**

	Shënimet	Për vitin e mbyllur më 31.12.2022 (në EUR '000)	Për vitin e mbyllur më 31.12.2021 (në EUR '000)
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</b>			
Fitimi neto para tatimit		118,742	47,222
Rregullimet për zërat jomonetar			
Zhvierësimi dhe amortizimi	4,5	48,462	57,278
Amortizimi i granteve	18	(22,245)	(8,688)
Të hyrat nga interesi	23	(5,600)	(375)
Shpenzimet e interesit	23	3,906	3,625
Provizionimi i borxheve të këqija	28.B	4,500	3,647
Provizionimi për kostot e mjedisit dhe pensione	14	(423)	6,507
Provizionimi për shlyerjet/kthimet e inventarëve	6	216	1,353
Shlyerja direkte e pasurive të tjera			-
Shlyerja e pronës, impianteve dhe paisjeve	4,5	44	139
<b>Fitimi para ndryshimeve në pasuritë dhe detyrimet operative</b>		<b>147,602</b>	<b>110,708</b>
Inventarët		(758)	(1,801)
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera		(24,490)	(17,097)
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera		13,040	(6,441)
<b>Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative</b>		<b>135,394</b>	<b>85,369</b>
Interesi i arkëtuar			-
Interesi i paguar		(2,956)	(3,054)
Tatimi mbi të ardhura i paguar		(10,933)	(3,758)
<b>Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet operative</b>		<b>121,505</b>	<b>78,557</b>
<b>Paraja nga aktivitetet investive</b>			
Blerja e pronës, impianteve dhe pajisjeve dhe pasurive të paprekshme	4,5	(10,108)	(32,581)
Zvogëlim/(Rritje) në depozita		(145,400)	-
<b>Paraja (e përdorur) në aktivitetet investive</b>		<b>(155,508)</b>	<b>(32,581)</b>
<b>Paraja nga aktivitetet financiare</b>			
Grantet e pranuar për importin e energjisë		30,000	20,000
Dividenda e paguar		-	(10,000)
Pagesa e huazimeve		(11,387)	(11,387)
<b>Paraja (e përdorur) në aktivitetet financiare</b>		<b>18,613</b>	<b>(1,387)</b>
<b>Ndryshimi neto në para dhe ekuivalentët e parasë</b>		<b>(15,390)</b>	<b>44,589</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit</b>		<b>112,517</b>	<b>67,928</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit</b>	8	<b>97,127</b>	<b>112,517</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shoqëruese të faqeve 12 deri 51 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare



**KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.**  
**Shënimet për pasqyrat financiare**  
**Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022**

**1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME**

Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A. ("Kompania" ose "KEK") është shoqëri aksionare inkorporuar në Kosovë dhe e regjistruar nën Agjencinë e Regjistrimit të biznesit në Kosovë nën numrin e regjistrimit 7032599 me datë 27 dhjetor 2005. Kompania u transformua në një ndërmarrje aksionare (Sh.A.) nën Misionin e Administratës së përkohshme të Kombeve të Bashkuara ("UNMIK") rregullorja nr. 2001/6. Adresa e selisë qendrore së saj të regjistruar është: Rruga Nënë Tereza Nr. 36, 10 000 Prishtinë, Kosovë.

Kapital fillestar i regjistruar i Kompanisë arrin në 25 mijë euro. Librat e Kompanisë janë hapur që nga 1 janari 2005 bazuar në Raportin e Due-Diligence Financiare sipas dates 01 janar 2005 nga një vlerësues i pavarur.

Kompania është 100% në pronësi të Republikës së Kosovës.

Aktivitetet kryesore të Kompanisë janë gjenerimi energjise dhe aktivitetet minerare si nxerrja e linjtit duke përdorur termocentralet e tij.

Struktura aktuale operative e Kompanisë përbëhet nga zyra qendrore e korporatës dhe divizionet e mëposhtëm:

- Divizioni i prodhimit të Linjtit;
- Divizioni i prodhimit të energjisë - Kosova A;
- Divizioni i prodhimit të energjisë - Kosova B;

Licenca e Korporatës Energjetike të Kosovës - Divizioni i prodhimit (KEK SHA) - TC Kosova A për prodhimin e energjisë elektrike zgjatet për periudhën nga 4 tetor 2022 deri më 4 tetor 2023 (numri i licencës ERO / Li\_05 / 17\_A) nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Për shkak të paaftësisë së Kompanisë për të marrë Lejen e Integruar Mjedisore nga MMPH licenca për Kosovën A rinovohet çdo vit.

Licenca e Korporatës Energjetike të Kosovës - Divizioni i prodhimit (KEK SHA) - TC Kosova B për prodhimin e energjisë elektrike zgjatet për periudhën nga 4 tetor 2006 deri më 4 tetor 2026 (numri i licencës ERO / Li\_05 / 17\_B) nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

Ndërsa më 13 prill 2017, Licenca e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK Sh.A), Divizioni i Prodhimit "TC Kosova B", me numër licence ZRRE / Li\_05 / 14\_B, është modifikuar në "Licencë e Kogjenerimit të Energjisë Elektrike dhe Termike" me numër të ri licence ZRRE / Libp\_05 / 17\_B lëshuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), të gjitha dispozitat e tjera të licencës së mëparshme mbeten në fuqi.

Ndërsa më 20 dhjetor 2018, Korporatës Energjetike të Kosovës ishte pajisur me licencën e re ERO/ Li\_60 / 17 për Furnizim me Energji Elektrike me vlefshmëri nga 20 dhjetor 2018 deri më 19 dhjetor 2043.

Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK SHA) gjatë dhjetorit 2014 filloi projektin për Kogjenerimin e Energjisë Termike ku energjia termike i shitet Termokos Sh.A me qëllim të sigurimit të furnizimit me ngrëhje në Prishtinë.

**2. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL**

**2.1 Deklarata e përputhshmërisë**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") të lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("IASB").

**2.2 Baza e përgatitjes**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç për Pronat, impiantet dhe pajisjet e blera para vitit 2005 të cilat mbahen me vlerë të drejtë, të cilat konsiderohen të jenë kosto në vitin e inkorporimit.

# KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS SH.A.

## Shënimet për pasqyrat financiare

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022

### 2. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

#### 2.3 Supozimi i parimit të vijimësisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijimësisë.

#### 2.4 Valuta funksionale dhe prezentimit

Valuta funksionale dhe raportuese e Kompanisë është euro (EUR) e cila është në pajtueshmëri me rregullativat e Unionit Monetar Europian dhe udhëzimet e lëshuara nga Banka Qendrore e Kosovës, valuta euro është adoptuar si valutë e vetme legale në territorin e Kosovës që nga 1 janari 2002.

Pasqyrat financiare janë përgaditur për vitet e përfunduara më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021. Të dhënat aktuale dhe krahasuese të deklaruara në këto pasqyra financiare janë të shprehura në mijëra euro, përveç nëse kërkohet të janë të shprehura ndryshe. Sipas nevojës, figurat krahasuese janë riklasifikuar në përputhje me ndryshimet e prezantimit për vitin.

#### 2.5 Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet e denominuara në valuta ndryshe nga euro janë të regjistruara në kursin e këmbimit që vendoset në datën e transaksionit. Diferencat e këmbimit që vijnë nga shlyerja e transaksioneve në monedhë të ndryshme nga euro, përfshihen në fitimin ose humbjen duke përdorur kursin e këmbimit që vendoset në atë datë.

Pasuritë dhe detyrimet të valutës monetare ndryshe nga euro përkthehen me kursin e këmbimit të tregut të mesëm në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në kurset e këmbimit pas datës së transaksionit njihen në fitim ose humbje pasi përkthimi i këmbimit valutor fiton më pak humbje.

#### 2.6 Prona, impiantet dhe paisjet

Zërat e pronës, impianteve dhe pajisjeve më 1 Janar 2005 janë riparaqitur me koston e konsideruar zvogëluar zhvlerësimin e akumuluar dhe dëmtimin, ndërsa zërat e pronës, impianteve dhe pajisjeve të blera mbas periudhës 1 janar 2005 paraqiten me kosto zvogëluar për zhvlerësimin e akumuluar dhe dëmtimin, nëse ka.

Kostoja e konsideruar përfaqëson vlerat fillestare të pasurive të vlerësuara nga Kompania me ndihmën e një konsulentit të pavarur në kohën e shndërrimit nga një Korporatë në një Shoqëri Aksionare, më 1 janar 2005.

Kostot e mëvonshme përfshihen në vlerën kontabël të pasurisë ose njihen si një pasuri e veçantë, sipas rastit, vetëm kur është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me zërin do të rrjedhin në kompani dhe kostoja e zërit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet e tjera i ngarkohen fitimit ose humbjes gjatë periudhës financiare në të cilën ato ndodhin.

Toka dhe pyjet mbahen sipas koston se vlerësuar dhe nuk zhvlerësohen. Zhvlerësimi në pasuritë e tjera është llogaritur duke përdorur metodën lineare për të shpërndarë kostot e tyre ose shumat e rivlerësuar të vlerave të mbetura mbi jetën e përdorimit të parashikuar, si vijon:

	2022	2021
Toka në mihje		
Ndërtesat	2-7 vite	2-7 vite
Pajisjet e rënda industriale	10-50 vite	10-50 vite
Automjetet	10-50 vite	8-20 vite
Mobilje, armature dhe pajisje	10-50 vite	6-7 vite
	10-50 vite	5-7 vite

Vlera e mbetur e pasurive dhe jeta e përdorimit janë rishikuar dhe rregulluar nëse ka qenë e përshtatshme, në secilën datë të pasqyrës së pozicionit financiar. Vlera bartëse e një pasurie është rritur menjëherë në shumën e rikuperueshme nëse vlera kontabël e pasurisë është më e madhe se shumata e vlerësuar e rikuperueshme.

## **2. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)**

Fitimet dhe humbjet nga shitja janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat me vlerën kontabël. Këto janë të përfshira në fitim ose humbje. Menaxhmenti i Kompanisë gjatë vitit 2021 ka vendosur të rishikojë politikën për zhvlerësimin e tokave të përdorura për nxjerrjen e qymyrit dhe për të përputhur kostot me të ardhurat e realizuara, ka vendosur që jetëgjatësia e dobishme e tokave minerare të përcaktohet sipas planeve të kompanisë për nxjerrjen e qymyrit.

### **2.7 Pasuritë e paprekshme**

Pasuritë e paprekshme me jetë të dobishme të kufizuar të cilat fitohen veçmas, mbarten me kosto zvogëluar amortizimin e akumuluar dhe humbje të akumuluar nga dëmtimi. Amortizimi njihet mbi baza lineare gjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar.

Jeta e dobishme dhe metoda e amortizimit rishikohen në fund të çdo periudhe raportimi, me efektin e çdo ndryshimi në vlerësim, të cilat llogariten mbi bazën e ardhshme.

Pasuritë e paprekshme me jetë të dobishme të papërcaktuar që janë fituar veçmas, mbarten me kosto zvogëluar humbjet e akumuluar nga dëmtimi.

### **2.8 Mosnjohja e pasurive të paprekshme**

Një pasuri e paprekshme nuk njihet në shitje ose kur nuk priten përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi ose shitja. Fitimet ose humbjet që rrjedhin nga çregjistrimi i një pasurie të paprekshme, maten si diferenca midis fitimit të asgjësimit neto dhe vlerës së mbartur të pasurisë, njihen në fitim ose humbje kur pasuria është çregjistruar.

### **2.9 Dëmtimi i pasurive jo - financiare**

